

VENDIM
Nr. 41, datë 4.8.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E
KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nënkreut II, të kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e datës së hyrjes në fuqi të shkronjës “a”, të pikës 1, të vendimit nr. 54, datë 2.9.2020, “Për disa ndryshime në rregulloren ‘Për mbikëqyrjen e konsoliduar’”, nga data 1 qershor 2021, në datën 1 janar 2022.
 2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko